

Data 29.05.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mobilje dhe pajisje per zyra dhe sallën e menzes”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39130000-2,
39221000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.726.320 (nje milion e shtateqind e njezet e gjashte mije e treqind e njezet) Leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislativës në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislativës përkatëse.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislativës në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8 Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të LPP “Për Prokurimin Publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55, pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet /furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.
- 2.4.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 14001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

- 2.4.3. Ofertuesi duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”. Në rastin kur ofertuesi nuk është prodhues, por distributor i autorizuar, të paraqesë edhe Çertifikatë ISO 45001:2018 ose ekuivalente për prodhuesin e deklaruar të pajisjeve të mobilimit të ofertuara, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të nenit 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” lidhur me certifikime të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

- 2.4.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar dhe Katalog Origjinal për produktet e ofruara i cili të ketë karakteristikat teknike në përputhje me specifikimet teknike.

Ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin për ofrimin e pajisjeve objekt të kësaj procedure. Autorizimi nga Prodhuesi duhet të përmbajë kontaktet e plota të prodhuesit (adresë, telefon, e-mail) në rast verifikimi.

- 2.4.5. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë se merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit, si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve objekt prokurimi dhe se ofron garanci për mallat objekt prokurimi për një periudhë 1-vjeçare të garancisë nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, transportimin, mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe shërbimin pa pagesë të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

- 2.4.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa me sipër mjeti nevojitet të jetë i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose

- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- a) Kontratë qiraje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë
- b) Leje qarkullimi e mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
- ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.4.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi/qira ose në përdorim të paktën 1 (një) ambient për prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi .

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të dorëzojë dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje, e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës dhe garancisë

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë ambientin që disponojnë sipas tabelës së mëposhtme

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim

2.3.1. Operatori ekonomik, ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të depozitojë pranë Autoritetit Kontraktor master për artikujt objekt prokurim :

Karrige rrotulluese

Karrige statike

Poltron drejtuesi

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" dhe pikës 6, gërma a dhe b, dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"**.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij, të cilat përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së.

ARTIKULLI	PERSHKRIMET/SPERCIFIKIMET TEKNIKE	NJESI MATESE	SASIA
Karrige rrotulluese	Karriget rrotulluese të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkurë ekologjike	cope	15
Banak recepsioni	Banak recepsioni. Recepsion me dy nivele, jo me të vogël se (150*60* h75cm) me lartësi te nivelit te dyte jo me të vogël se 110 cm, me gjerësi jo me të vogël se 25 cm, i cili do te jete ne anen e vizitorit . Mobilja duhet te jete e hapur nga ana e operatorit per pozicionim e kembeve. Materiali do te jete laminant me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar. Syprina e dyte duhet të jetë me material laminat me bordure te plastifikuar. Në brendësi, recepsioni do të ketë 3 komodina me nga 3 sirtarë, me përmasa jo më të vogla se (45*45*h65 cm) me material laminat me trashësi jo me të vogël se 2.5 cm me bordurë të plastifikuar, me 4 rrota.	cope	1
Sirtariere	Përmasat e komedines (gjerësi x thellësi x lartësi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (së bashku me rrotat) Struktura e sirtarierës të jetë melaminë me trashësi 16 mm deri 18 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballore të sirtareve duhet të jenë prej material melaminë me spesor jo me te vogel se 1.8cm. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4(kater) rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i parë nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3(tre) sirtarë të barabartë. Dy prej sirtarëve duhet të jenë të paisur me çelës. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës.	cope	10
Karrige statike	Karrige statike. Karriget të jenë dizenuara me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval jo me te vogel se 30 x15 mm, me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lyerje elektrostatike në temperaturë 240°C. Në pjesën e brendshme me një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja jane material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof cilësor ose lëkurë ekologjike.	cope	30
Tavoline mesi	Dimensione Syprina 90x70 cm Lartësia nga toka 44 cm Suprina e tavolines se mesit do te jete prej melamine (dopio) 18 mml me bordim 36 mm. Kembet gjithashtu do te jene prej material melamine 25 mm borduar me PVC. Aksesoret e montimit duhet te jene te padukshem. Ngjyra dhe disenjoja do te percaktohen ne kushtet e lidhjes se kontrates	cope	1

Set Kolltuqe	Seti i kolltuqeve te zyres se drejtuesit duhet te jete i perbere nga nje kolltuk tek dhe dy kolltuke dysh. Veshja e kolltuqeve duhet te jete me lekure ekologjike cilesore. Dimensionet duhet te jene standarde per kete produkt dhe ne perputhje me dimensionet e konfigurimin e zyres.	set	1
Poltrona drejtuesi rotulluese	Poltrona rotullues të kenë shpinore të rregjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Poltrona do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali metalik te kromuar me 5 (pese) rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karriges të jenë metalik/plastik/dru estetik dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jëtë në stof cilësor ose lëkure ekologjike me shtrese te bollshme me mbushje sfungjeri.	cope	1
Varese rrobash statike	Varese rrobash statike me grepa	cope	3
Tavoline mense	Tavolina per mensen 150x70x75	cope	3
Frigorifer	Lloji i ftohjes: ME AJER Kapaciteti total: 324 Zona e freskise: PO Nderrimi i hapjes se deres: PO Paneli i kontrollit: Elektronik Opsione Ekstra: NeoFrost Dual Cooling Klasi i energjise: E Mbrojtja e ushqimeve: HarvestFresh Opsioni i pushimeve: Alarm tek dera Ndricimi i brendshem: LED Ftohje e shpejte: PO Kapaciteti NETO (Ngriresi/Freskuesi): 109 / 215 Kompresori: I thjeshte Niveli i zhurmes (dBA): 38 dBA Tipi i vendosjes: Qendrim i lire	cope	1
Mikrovale	Madhesia e pjates (cm): min 32 cm Nivelet e fuqise: min 5 Fuqia e mikrovalet (Watt): jo me pak se 1400 W Funksionimi: Ngrohje / Grile Komandimi: Elektronik + Mekanik Kapaciteti (L): min 28 L Fuqia e griles (Watt): min 1500 W	cope	2